



Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Dibrës

SHTATOR 2022

Autorët: [Deanna Davy](#), Konsulente Ndërkombëtare për UNICEF në Shqipëri
[Blerina Metanji](#), IDRA Albania

Menaxhere Studimi: [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

Redaktor: [Iain Wilson](#)

Ky dokument u përgatit në kuadrin e Programit “*Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria*”, zbatuar nga një koalicion prej gjashtë organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare: UNICEF në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të UNICEF-it apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materialin e këtij raporti në botimet e tyre, me kushtin që të citojnë burimin.

Citimi i rekomanduar për Raportin:

Davy, D., dhe Metanji, B. (2022) “*Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë - Vala e dytë. Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Dibrës*” UNICEF në Shqipëri dhe IDRA.

Për komente, korrigjime dhe sugjerime, ju lutemi kontaktoni në adresën: tirana@unicef.org

Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Dibrës

Shtator 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	4
2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	5
3. METODOLOGJIA	6
4. GJETJE	8
5. PËRFUNDIME	23

1. HYRJE

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një sërë politikash dhe mekanizmash për të luftuar fenomenin. Vendi njihet si vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Përmes rrjeteve të organizuara kriminale, shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës. Megjithatë, trafikimi brenda vendit ka qenë një fenomen i konsiderueshëm për rreth dy dekada, ku shumica e viktimave vendase janë fëmijë dhe të rinj. Shumë viktimë shqiptare vijnë nga familje të varfra, janë të papunë dhe të paarsimuar. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e riskut e kanë zanafillën kryesisht nga situata familjare, dhe përfshijnë ndarjen ose braktisjen e familjes. Pasojë e këtyre faktorëve është fakti që atyre iu mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes.

Pavarësisht të dhënave të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, ka mungesë literature në nivelin e njohurive të tyre për fenomenin brenda vendit, ose në qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me të. Vetëm një studim i fundit (2016) trajton njohuritë dhe ndërgjegjësimin rreth trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri.¹ Nga ky studim, ne kuptojmë se: të rriturit shqiptarë kanë më shumë dijeni rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime pune; mbi gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz, i cili lidhet kryesisht me gratë dhe fëmijët; dhe se shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e dyshuara.

Duke qenë se ai studim nuk trajtoi posaçërisht nivelin e njohurive të të rinjve, ose qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, studimi aktual e shqyrton këtë çështje me qëllim plotësimin e mangësive të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit do të jenë të dobishme për qeverinë dhe palët e interesit joqeveritare që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi aktual është një anketë e valës së dytë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të vendit, dhe ndërmjet romëve. Kjo anketë pason atë të valës së parë, rezultatet e së cilës u publikuan në dhjetor 2020.² Kjo anketë e valës së dytë përsërit pyetjet e valës së parë në masën maksimale të mundshme.

Ky raport përqendrohet vetëm në qarkun e Dibrës në Shqipëri, për të krahasuar rezultatet e anketës në Dibër me ato të tre qarqeve të tjera: Kukës, Shkodër dhe Tiranë. Një raport i përgjithshëm që paraqet gjetjet e anketës, së bashku me katër raportet e qarqeve dhe një raport për romët është publikuar. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.³

Paraqitja e rezultateve në nivel qarku është hartuar për të udhëhequr zhvillimin e përpjekjeve të komunikimit për trafikimin e qenieve njerëzore të përshtatura me kontekstin. Krahasimi këtu nuk bëhet ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe të valës së dytë pasi ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe praktika janë minimale. Duhet theksuar se aty ku nuk trajtohen të dhënat në tabela dhe shifrat ka të bëjë me faktin se ndryshimet janë të papërfillshme.

¹ USAID, 2016, Matja e opinionit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur anketa eksperimentuese për të informuar programet efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

² Davy, D., dhe Metanj, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport mbi gjetjet](#). Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, IDRA, UNICEF në Shqipëri:

³ [Paneli i studimit](#)

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij studimi synohet të kuptohet dhe eksplorohej niveli i ⁴njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe ndërmjet të rinjve romë.

Objektivat e studimit ishin krahasimi i diferencave në nivelet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në katër qarqe:

Njohuritë

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore
- Format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja
- Kush është në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore
- Metodatat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore
- Mënyrat për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore
- Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat

Qëndrimet

- Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore
- Qëndrimet nga viktimave

Praktikat

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore

2.1 Rezultatet e komunikimeve të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rrjedhojë e ekspozimit.

2.2 Struktura e raportit

Pas këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimit, e pasuar nga gjetjet mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti mbyllet me një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore.

⁴ Grupmosha 15–29 vjeç, siç përcaktohet nga Komisioni Evropian. Shihni EUROSTAT, Të rinjtë - Vështrim i përgjithshëm, ⁴<https://ec.europa.eu/eurostat/web/youth>.

3. METODOLOGJIA

3.1 Qasja ndaj anketës

Studimi aktual ka anketuar rreth 1,600 të rinj (Tabela 1), duke përfshirë të anketuar të grupmoshës 15-29 vjeç që jetojnë në Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë (350 të anketuar në secilin qark). Kampioni përfshiu një kampion plotësues prej 200 të rinjsh të popullatës rome që jetojnë në Kukës, Shkodër dhe Tiranë.

Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Të dhënat zyrtare⁵ tregojnë se janë në total rreth 300,000 persona të moshës 15-29 vjeç që jetojnë në katër qarqet ku u krye studimi. Si rrjedhojë përmasa e kampionit të rreth 1,600 të anketuarve garanton rezultate përfaqësuese në nivel kombëtar me marzh gabimi prej 2.62 për qind dhe me interval besimi prej 95%. Marzhi i gabimit në nivel qarku është 5.24 për qind me interval besimi prej 95 për qind (shihni Aneksin për një vështrim të përgjithshëm të metodologjisë). Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë për ballë.

Vetëm një person për familje i grupmoshës 15-29 u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja në mënyrë rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri. Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri në 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta.

3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye nga IDRA duke përdorur paketën softuerike të të dhënave statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat u ponderuan për të qenë përfaqësuese për secilin qark dhe në tërësi. Kjo u bë në mënyrë që kontributi i të anketuarve nga secili qark të ishte proporcional me shifrat e popullsisë së qarkut. Rezultatet u ndanë sipas treguesve demografikë kryesorë, si gjinia dhe mosha.

3.3 Konsideratat etike

Anketa për trafikimin e qenieve njerëzore nuk përmbante pyetje të vështira ose të ndjeshme për të rinjtë. Megjithatë, u krye një vlerësim i etikës, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijë të grupmoshës 15-17 vjeç dhe më të rritur (18-29 vjeç). Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi mori miratimin etik nga Health Media Lab. Ltd. Bordi i Rishikimit të Etikës.⁶

Për këtë studim, ekipi respektoi sa më poshtë vijon:

- Rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, dhe në veçanti nenin 1.1.4 i cili u kërkon institucioneve “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim”. Ky udhëzim (rregullorë) u lëshua nga Qeveria e Shqipërisë për të orientuar çështjet e lidhura me etikën për shoqëritë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë punë kërkimore.
- Procedurat e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhje dhe Analizë të Dhënash (2021).

Ekipi i kërkimit respektoi standardet e mëposhtme themelore:

- se subjektet nuk vihen në risk të tepruar;
- se pjesëmarrja është vullnetare, dhe subjektet pajisen dhe bien dakord për pëlqimin e informuar para pjesëmarrjes së tyre; dhe

Tabela 1. Numri i intervistave të anketës të kryera në secilin qark të synuar dhe me romët

Qarku	Nr.
Tiranë	350
Shkodër	350
Kukës	341
Dibër	346
Totali, 4 qarqe	1,387
Rom/e	200
Totali i të anketuarve (Nr.)	1,587

⁵ Instituti i Statistikave i Shqipërisë: Rezultatet e Censurit të 2011; aksesuar për herë të fundit në korrik 2022: <http://www.instat.gov.al/en/themes/censuses/census-of-population-and-housing/#tab2>

⁶ Shihni <https://www.healthmedialabirb.com/>

- se ekzistojnë protokollet me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit ndanë fletëpalosje me pjesëmarrësit në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion për shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

4. GJETJE

4.1 Profili i të rinjve të anketuar në Dibër

Nga 346 të rinj të anketuar në Dibër, 39 për qind ishin femra dhe 61 për qind ishin meshkuj (Figura 1). Shumica e të rinjve të anketuar (47%) ishin të grupmoshës 18–24 vjeç, 29 për qind të grupmoshës 15–17 vjeç, dhe 23 për qind të grupmoshës 25–29 vjeç (Figura 2).

Figura 1. Të anketuarit e anketës sipas seksit






Figura 2. Të anketuarit e anketës sipas grupmoshës



Për sa i përket urbanitetit, 65 për qind e të rinjve të anketuar në Dibër jetonin në zona rurale dhe 35 për qind në zona urbane (Figura 3).

Figura 3. Të anketuarit e anketës sipas urbanitetit




4.2 Njohuritë rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

Të dhënat e anketës tregojnë se **shumica e të rinjve e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja** (Figura 4). **Megjithatë, të rinjtë kanë më pak njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe madje më pak akoma për faktin që ndodh në komunitetin ose zonën e tyre.** Dyzet e katër për qind e të rinjve të anketuar mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë në vende të huaja ndodh në masë shumë të madhe ose të madhe, **krahasuar me 27 për qind të popullsisë së anketuar në katër qarqe.** Vetëm gjashtë për qind mendojnë se ndodh në komunitetin ose zonën e tyre në këtë masë. Për ta krahasuar, **shumë pak të rinj nga Dibra e dinë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore, sesa popullatës së anketuar në katër qarqet.**


Figura 4. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, në ç'masë ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (shtetasve shqiptarë) në vende të huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin ose zonën tuaj? **Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve "në masë shumë të madhe" dhe "në masë të madhe".** **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Dibër, femrat kanë më shumë njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 5).


Figura 5. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas seksit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve "në masë shumë të madhe" dhe "në masë të madhe". **Popullata e synuar:** Dibër.

Rezultatet sipas grupmoshës (Figura 6) tregojnë se më të rinjtë në Dibër (p.sh. ata të moshës 25-29 vjeç) kanë një nivel shumë më të ulët të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore në vende të tjera, brenda Shqipërisë dhe në komunitetin ose zonën e tyre sesa të rinjtë e tjerë.


Figura 6. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Dibër.

Tridhjetë e një për qind e të rinjve të anketuar në zonat rurale në Dibër mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri ndodh në masë të madhe (Figura 7), krahasuar me vetëm 20 për qind e të rinjve në zonat urbane, me pak diferencë midis këtyre grupeve në njohuritë e tyre rreth trafikimit në vende të huaja dhe brenda komunitetit ose zonës së tyre.

Figura 7. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas urbanitetit.



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Dibër.

Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

Në përgjithësi, **të rinjtë e anketuar në Dibër kanë më pak njohuri krahasuar me popullatën e katër qarqeve për format e shfrytëzimit në Shqipëri dhe jashtë vendit** (Tabela 2), veçanërisht për sa i përket kriminalitetit të detyruar te të rriturit.

Tabela 2. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit (%)

Forma e shfrytëzimit	Në Shqipëri		Jashtë vendit	
	Dibër	Totali, 4 qarqe	Dibër	Totali, 4 qarqe
shfrytëzimi seksual i të rriturve	70	80	66	76
shfrytëzimi seksual i fëmijëve	74	87	66	73
puna e detyruar e të rriturve	56	70	59	67
puna e detyruar e fëmijëve	71	83	71	70
martesa e detyruar	61	67	56	56
martesa e hershme	81	85	64	57
lypja e detyruar e të rriturve	59	66	56	56
lypja e detyruar e fëmijëve	86	93	73	76
kriminaliteti i detyruar i të rriturve	65	81	62	81
kriminaliteti i detyruar i fëmijëve	71	83	69	76
N.	346	1,387	346	1,387

Pyetje ankete: Në ditën tuaj, a ndodhin format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, në Shqipëri dhe në vende të huaja? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes “po”. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Grupet në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore

Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të anshëm gjinor të të rinjtë e Dibrës lidhur me grupet e personave në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Tabela 3). Grupi i konsideruar nga të rinjtë të anketuar si më shumë në risk janë vajzat nën 18 vjeç. Gjashtëdhjetë e shtatë përqind e të rinjve të anketuar në Dibër e konsiderojnë këtë grup si shumë në risk nga trafikimi, i ndjekur nga pakicat kombëtare (43%). **Vetëm tre për qind mendojnë se meshkujt e moshës 18 vjeç ose më shumë janë në risk të lartë dhe vetëm 16 për qind se djemtë janë në risk të lartë për t'u trafikuar.**


Tabela 3. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar (%)

Grupi i popullatës	Total, Dibër	Totali, 4 qarqe
gra (18 dhe mbi 18 vjeç)	23	37
vajza (nën 18 vjeç)	67	77
burra (18 dhe mbi 18 vjeç)	3	5
djem (nën 18 vjeç)	16	26
pakica kombëtare	43	47
persona nga zona rurale	23	30
N.	346	1,387

Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Dibër, femrat kanë më shumë njohuri për personat në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 8). Për shembull, 64 për qind e femrave të reja të anketuara janë të njohura me faktin se pakicat kombëtare janë në risk, krahasuar me vetëm 24 për qind të të rinjve në zona rurale.


Figura 8. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas seksit



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, në ç'masë mendoji se secili nga grupet e mëposhtme të popullsisë janë konsiderueshëm ose në risk të lartë për t'u trafikuar? Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Ka variacion mes kategorive të ndryshme të moshës në Dibër për njohuritë e personave në risk për t'u trafikuar (Figura 9), por mund të bëhen disa komente përmbyllëse se cili grup ka njohuri më të mira për grupet në risk. Më të rinjtë se 25-29 vjeç dinë më pak se vajzat (nën 18 vjeç) dhe pakicat kombëtare janë në risk trafikimi.

Figura 9. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas grupmoshës




Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane të Dibrës kanë më shumë njohuri sesa ata në zonat rurale rreth personave në risk për t'u trafikuar (Figura 10). Për shembull 22 për qind e atyre nga zonat

urbane e dinë se djemtë janë në risk për trafikimin e qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 12 për qind të të rinjve nga zonat rurale.

Figura 10. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore

Me qëllim vlerësimin e njohurive të të rinjve të anketuar në Dibër sa u përket metodave të rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë u pyetën nëse ishin dakord me disa pohime lidhur me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore. Rezultatet (Tabela 4) tregojnë se ata i zotërojnë këto njohuri, **ndonëse shumë pak e dinë se që pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore** (43% krahasuar me 48% të popullatës të anketuar në katër qarqe).


Tabela 4. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore (%)

Metoda e rekrutimit	Total Dibër	Total, qarqet
Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale	89	90
Për të rekrutuar viktimat mund të përdoret interneti	90	94
Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë shokët	79	86
Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë anëtarët e familjes	43	48
Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë të dashurit ose të dashurat	80	85
N.	346	1,387

Pyetje ankete: Në ç'masë jeni dakord ose jo me pohimet e mëposhtme? Tabela raporton përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Në grupin e të rinjve të anketuar në Dibër, femrat kanë njohuri më të mira se meshkujt rreth metodave të rekrutimit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikantëve të qenieve njerëzore (Figura 11). Në veçanti, femrat kanë më shumë njohuri që pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore (58% krahasuar me 30% të meshkujve).


Figura 11. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Dibër.

Në Dibër, të rinjtë e moshës 15-17 vjeç kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore (Figura 12). Për shembull, vetëm 15% të 17-42 vjeçarëve mendojnë se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë qeniesh njerëzore, krahasuar me 18% të 24-32 dhe 25-29 vjeçarëve.


Figura 12. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Dibër.

Të rinjtë që jetojnë në zonat urbane në Dibër dinë më shumë sesa ata në zonat rurale për metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore (Figura 13), ndonëse diferencat janë të pakta (p.sh., 45% dhe 42% përkatësisht, mendojnë se pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë)

Figura 13. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Dibër.

Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Dibër kanë më pak njohuri sesa popullata totale e anketuar mbi pjesën më të madhe të mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 14). Për shembull, vetëm 78 për qind e të rinjve në Dibër e dinë që mund të raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në stacionin e policisë, krahasuar me 85 për qind të popullsisë së gjerë.

Figura 14. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Ka një variacion në njohuritë e mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore të plotësueset femra dhe plotësuesit meshkuj të anketës (Tabela 5). **Për shembull, më shumë të reja femra sesa të rinj meshkuj të anketuar e dinë që mund të raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e policisë (87% dhe 71% përkatësisht). Megjithatë, më shumë meshkuj sesa femra e dinë që mund të raportojnë rastet e dyshuara në numrin e linjës së këshillimit 129 (77% dhe 62% përkatësisht).** Ekziston variacioni në këto njohuri edhe te grupmoshat e ndryshme të të rinjve. 15-17 vjeçarët kanë më shumë njohuri për raportimin e rasteve të dyshuara në rajonin e policisë krahasuar me të rinjtë e tjerë, ndërsa më shumë 25-29 vjeçarë (81%) e dinë që mund të raportojnë në linjën e këshillimit 129 të Policisë sesa 15-17 vjeçarët (62%). **Ndërkohë, të rinjtë që jetojnë në pjesët rurale të Dibrës kanë më pak njohur rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në zonat urbane** (p.sh., 11% dhe 21% përkatësisht, e dinë për linjën kombëtare për këshillimin e fëmijëve).


Tabela 5. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore, sipas seksit, grupmoshës, dhe urbanitetit (%).

Ku të raportoni raste trafikimi	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
rajon policie	87	71	82	79	71	80	77
linja telefonike e policisë 129	62	77	62	71	81	66	72
mësues, psikolog, profesionist tjetër në shkollë	36	28	39	27	32	36	29
punonjës i mbrojtjes së fëmijës	12	8	13	8	7	15	7
Organizatë Jofitimprurëse	7	10	6	9	12	10	8
mjek, infermier	8	10	9	7	13	9	9
linja kombëtare për këshillimin e fëmijëve ALO 116	19	10	18	13	12	21	11
linja telefonike kombëtare (116 006)	11	7	9	8	9	12	7
aplikacion telefonik ("Telefono, Raporto!")	10	6	9	9	5	7	8
profesionist tjetër në bashki ose njësinë administrative përkatëse	4	3	4	3	4	5	3
asnjëra nga alternativat e mësipërme	1	3	3	3	1	2	2
dhe	2	0	3	0	0	2	1
nuk u dha përgjigje	1	1	1	2	1	2	1
N.	135	211	101	164	81	121	225

Popullata e synuar: Dibër

Vetëm 34 për qind e të rinjve në Dibër njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 49 për qind në popullatën e përgjithshme të anketuar në katër qarqet (Figura 15).

Figura 15. Njohuri për të paktën tri mënyra për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore



Popullata e synuar: Dibër; Totali, 4 qarqe.

Të dhënat e anketës tregojnë se raportimi ballë për ballë është mënyra e preferuar e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 6), dhe veçanërisht te të rinjtë e anketuar në Dibër **(81% krahasuar me 72% e popullatës së anketuar në katër qarqet).**

Tabela 6. Kanalet e parapëlqyera të raportimit të një rasti të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore (%)


Mënyrat e raportimit të rastit të trafikimit	Qarku	
	Total, Dibër	Totali, 4 qarqe
ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese (polici, prokurori)	81	72
shërbimet telefonike (linjat e këshillimit, linjat e ndihmës)	23	36
raportimi ballë për ballë tek institucionet joligjzbatuese	17	24
OJF e specializuar për çështjen	7	12
platformë në internet, aplikacion telefoni	6	9
asnjëra nga alternativat e mësipërme	3	4
nuk u dha përgjigje	2	1
N.	346	1,387

Pyetje ankete: Cilin nga kanalet e mëposhtme do të konsideronit ose do të parapëlqenit për raportimin e një rasti trafikimi qeniesh njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë në Dibër dinë më pak se popullata më e gjerë për pjesën më të madhe të shërbimeve të mbështetjes të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore përkatësisht me 41 për qind dhe 27 për qind, që nuk kanë asnjë njohuri për asnjë lloj mbështetjeje. (Figura 16)

Figura 16. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Dibër, femrat kanë më shumë njohuri sesa meshkujt për llojet e mbështetjes të disponueshme në vend për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, ndërsa meshkujt dinë më shumë rreth llojeve të tjera të mbështetjes (Tabela 7). Ndërkohë, të rinjtë e moshës 25-29 vjeç kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë për lloje të caktuara mbështetjeje, veçanërisht për mbështetjen psikosociale, mbështetjen sociale nga OJF-të dhe këshillimin nëpërmjet linjave telefonike, si dhe akomodimin në streha. Nuk ka dallime të konsiderueshme mes të rinjve në zonat urbane dhe atyre në zonat rurale në Dibër për sa i përket njohurive për pjesën më të madhe të shërbimeve të disponueshme për viktimat e trafikimit, përveç mbështetjes për strehim (20% e të rinjve krahasuar me 11% të banorëve të qytetit).


Tabela 7. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit (%)

Lloji i mbështetjes për viktimat	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15–17	18–24	25–29	Urban	Rural
mbështetje e posaçme nga policia e shtetit	13	23	16	15	29	18	19
mbështetje psiko-sociale (shëndeti mendor)	39	38	42	33	44	37	39
mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga qeveria	21	18	24	12	30	20	19
mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga OJF-të	11	11	13	7	18	13	11
mbështetje për strehim	20	15	17	12	28	11	20
këshillim, mbështetje nëpërmjet linjave telefonike të këshillimit ose ndihmës	10	7	13	6	8	5	10
akomodim në strehë	6	7	7	4	10	2	9
mbështetje financiare	15	13	12	12	21	14	14
mbështetje për punësim	12	11	12	11	10	11	11
mbështetje mjekësore	14	13	12	14	15	12	14
këshillim për të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme	10	10	9	8	15	8	11
mbështetje e posaçme për trajnim ose arsimim	7	5	6	3	10	6	6
nuk e dinte ose nuk u përgjigj	39	42	38	49	26	41	41
N.	135	211	101	164	81	121	225

Popullata e synuar: Dibër.

Ndërkohë, vetëm 27 për qind e të rinjve të anketuar në Dibër ishin në dijeni për të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit, krahasuar me 39 për qind të popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet (Figura 17).

Figura 17. Njohuri rreth të paktën tri formave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri




Popullata e synuar: Dibër; Totali, 4 qarqe.

4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Niveli i shqetësimit

Shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore është pak më i lartë mes të rinjve e anketuar në Dibër sesa në popullatën totale të anketuar në katër qarqe (74% dhe 69% përkatësisht; Figura 18).


Figura 18. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetje ankete: Sa i/e shqetësuar jeni për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri? *Popullata e synuar:* Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Dibër, meshkujt janë më pak të shqetësuar sesa femrat në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri (65% dhe 85%, përkatësisht janë shumë të shqetësuar; Figura 19).


Figura 19. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Të rinjtë e moshës 15-17 vjeç janë më pak të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri sesa të rinjtë e tjerë (Figura 20).


Figura 20. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Ndërkohë, të rinjtë që jetojnë në zona urbane në Dibër janë më të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore sesa ata që jetojnë në zona rurale (79% dhe 72% përkatësisht; Figura 21).

Figura 21. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Të rinjtë e anketuar në Dibër raportuan se janë më të shqetësuar për moszbatimin e ligjit dhe shtimin e numrit të të rinjve dhe fëmijëve të trafikuar (Tabela 8).

Te të rinjtë në Dibër, më shumë femra (83%) sesa meshkuj (77%) janë të shqetësuar për moszbatimin e ligjit dhe më shumë femra (74%) sesa meshkuj (55%) janë të shqetësuar për shtimin e numrit të të rinjve dhe fëmijëve të trafikuar. Ndërkohë më shumë të rinj që jetojnë në zona rurale (85%) sesa ata që jetojnë në zona urbane (70%) janë të shqetësuar për moszbatimin e ligjit.

Tabela 8. Fushat më kryesore të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)


Fusha e shqetësimit	Totali		Dibër						
	Dibër	4 qarqe	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
			F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
mungesa e zbatimit të ligjit	80	72	83	77	75	82	80	70	85
rritja e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve	64	63	74	55	66	63	63	62	65
niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me këtë fenomen	26	47	27	25	24	24	32	34	22
besueshmëria e ulët të institucionet përkatëse ku raportohen raste të tilla	30	41	31	29	21	31	40	34	27
mbështetja e pamjaftueshme për viktimat	22	34	24	21	20	24	22	27	20
rritja e trafikimit të të rriturve	22	28	25	20	20	23	25	27	20
lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore	17	28	15	18	10	18	23	22	14
lidhja ndërmjet migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore	10	17	10	10	7	10	15	12	9
Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0
N.	135	211	101	164	81	121	225	135	211

Pyetje ankete: Çfarë ju shqetëson më shumë? Zgjedhje të shumëfishta. Popullata e synuar: Dibër; Totali, 4 qarqe.

Qëndrimet ndaj viktimave

Pjesa më e madhe e të rinjve në Dibër (90%) besojnë se viktimave të trafikimit duhet t'i ofrohet mbështetje (Figura 22), në përputhje me rezultatet e përgjithshme të anketës së popullsisë në katër qarqet (90%).

Figura 22. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar



Pyetja e anketës: Sa mbështetës/e jeni ndaj ofrimit të mbështetjes së veçantë për viktimat e trafikimit ose personat në risk për t'u trafikuar? **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë e anketuar, **më shumë femra (97%) sesa meshkuj (83%) kanë empati kundrejt viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore** (Tabela 9), dhe të rinjtë e moshave 15-17 vjeç kanë më shumë empati kundrejt viktimave sesa të rinjve të tjerë (92% krahasuar me 88% të moshës 18-24 vjeç dhe 90% të moshës 25-29 vjeç). Ndërkohë, për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ka më pak empati në zonat rurale në Dibër, ku 87 për qind e të rinjve të anketuar besojnë se viktimave duhet t'u ofrohet mbështetje, krahasuar me 94 për qind e të rinjve që jetojnë në zonat urbane.

Tabela 9. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)

Niveli i dakordimit	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
jashtëzakonisht ose shumë	97	83	92	88	90	94	87
disi	2	11	5	7	9	3	9
pak ose aspak	0	2	1	2	1	1	2
nd ose np	1	3	2	3	0	2	2
N.	135	211	101	164	81	121	225


Popullata e synuar: Dibër. nd - nuk e di; np - nuk u përgjigj.

4.4 Praktikrat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Dibër kanë nivele të ngjashme interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore si të rinjtë e tjerë të anketuar (Figura 23). **Të rinjtë në Dibër janë më shumë të interesuar të dinë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje (40%).**


Figura 23. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Deri në cilën masë jeni i / e interesuar për të mësuar rreth këtyre aktiviteteve? Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Dibër, femrat kanë më shumë interes të mësojnë për trafikimin e qenieve njerëzore sesa meshkujt (Figura 24). Më shumë se gjysma e femrave (50-59%) janë të interesuara për të gjitha kategoritë e të nxëniet në pyetjet e anketës, krahasuar me më pak se një çerekun e meshkujve (18-25%).

Figura 24. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Në Dibër, më të rinjtë (15-17 vjeç) janë më të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të më të mëdhenjtë (Tabela 10). Për shembull, 47 për qind e 15-17 vjeçarëve janë të interesuar të mësojnë se kush është në risk t'u trafikuar, krahasuar me vetëm 30 për qind të 18-24 vjeçarëve dhe 31 për qind të 25-29 vjeçarëve.


Tabela 10. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Çështje e trafikimit të qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Kush është në risk për t'u trafikuar	47	30	31
Format e ndryshme të shfrytëzimit	45	29	25
Kush mund të jetë trafikant ose profili i trafikantëve	47	32	29
Metodat ose taktikat e rekrutimit të viktimave	45	32	29
Mënyrat për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore	45	37	33
Ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje	48	37	37
N.	101	164	81

Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane në Dibër janë më shumë të interesuar të mësojnë rreth pjesës më të madhe të veprimtarive të sugjeruara të trafikimit të qenieve njerëzore, se sa të rinjtë në zonat rurale (Figura 25). Për shembull, 42 për qind e personave nga zonat urbane janë të interesuar të mësojnë rreth metodave dhe taktikave të rekrutimit të viktimave, krahasuar me 32 për qind të zonave rurale.

Figura 25. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Interesi për t'u përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore

Të rinjtë në Dibër janë shumë më të interesuar për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata e përgjithshme në të katërta qarqet (Tabela 11).

Të rinjtë në Dibër janë më të interesuar të informojnë familjen dhe miqtë e tyre për problematikat e trafikimit të qenieve njerëzore (71%) dhe të ofrojnë ndihmë ose mbështetje për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit (67%). Ata janë më pak të interesuar të punojnë vullnetarisht për një organizatë joqeveritare (49%) ose në programe kundër trafikimit (50%).


Tabela 11. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore	Total, Dibër	Totali, 4 qarqe
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	67	59
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	64	55
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	71	61
Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je	49	39
Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	50	40
Raportimi për një viktimë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore	60	59
Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore	58	57
N.	346	1,387

Pyetje ankete: Sa i/e interesuar do të ishit të përfshiheshit në aktivitetet e mëposhtme? Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër; Totali, 4 qarqe.

Të rejtat e anketuara në Dibër janë shumë më të interesuara të përfshihen në aktivitetet e trafikimit të qenieve njerëzore se sa të rinjtë (Figura 26). Në të gjitha kategoritë e anketës në fjalë 66-87 për qind e femrave raportuan se janë të interesuar në përfshirjen në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 34-58 për qind të meshkujve.

Figura 26. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë 'shumë' ose 'disi të interesuar'. **Popullata e synuar:** Dibër

Më të rinjtë e anketuar (15-17 vjeç) janë më të interesuar të angazhohen në aktivitetet e lidhura me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave se sa më të mëdhenjtë (Tabela 12).


Tabela 12. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	71	65	65
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	77	62	49
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	80	69	64
Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je	60	48	37
Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	62	46	40
Raportimi për një viktimitë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore	71	56	52
Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore	67	54	55
N	101	164	81

Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

Te të rinjtë e anketuar në Dibër, ata që jetojnë në zona urbane janë më të interesuar të përfshihen në veprimtari kundër trafikimit të qenieve njerëzore se sa të rinjtë në zona rurale (Figura 27). Për shembull, 74 për qind e të parëve janë të interesuar të angazhohen në diskutime apo aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore në shkollë ose komunitet, krahasuar me vetëm 59% të këtyre të fundit.

Figura 27. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Dibër.

4.5 Rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

Thuhet gjysma (47%) e të rinjve të anketuar raportojnë se janë ekspozuar ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit (Figura 28).⁷ Nga ata që raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të tilla, 60 për qind ishin ekspozuar nëpërmjet diskutimeve në shkollë, 51 për qind nëpërmjet televizionit, 26 për qind nëpërmjet Instagramit, 22 për qind nëpërmjet fletëpalosjeve ose materialeve të printuara dhe 20 për qind nëpërmjet Facebook (Meta).


Figura 28. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Nëpërmjet cilit kanal komunikimi të mëposhtëm u informuat për ngjarjet, mesazhet ose materialet e komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Të rinjtë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Dibër.

Pothuajse të gjithë ata që ishin ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore në dy vitet e fundit (**98%**) raportuan se njohuritë e tyre për trafikimin e qenieve njerëzore janë shtuar si rezultat i ekspozimit (14% në masë shumë të madhe, 67% në masë të madhe, dhe 17% në një farë mase; Figura 29).

Figura 29. Masa e përmirësimit të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit




Pyetje ankete: Deri në ç'masë është përmirësuar niveli juaj i njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Dibër.

Për më tepër, thuhet të gjithë (97%) të rinjtë e ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore në dy vitet e fundit deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër këtij fenomen (10% në nivel shumë të lartë, 70% në nivel të lartë; 17% disi, Figura 30).

⁷Kjo i referohet punës së ndërmarrë nga UNICEF Shqipëri dhe partnerëve të tij në kuadrin e Programit Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria, nga prilli i vitit 2020 deri në momentin e intervistës së anketës.

Figura 30. Masa e ndryshimit të qëndrimeve pas ekspozimit ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Deri në ç'masë ka ndryshuar qëndrimi juaj lidhur me përfshirjen më aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Dibër.

5. PËRFUNDIME

Ky raport paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë dhe mundëson pikëpamje të vlefshme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve në Dibër sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Këto gjetje do t'u shërbejnë subjekteve të përfshira në aktivitetet kundër trafikimit në fushat e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave.

Për sa i përket nivelit të njohurive, të dhënat e anketës tregojnë se pjesa më e madhe e të rinjve në Dibër e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja, por më pak e dinë se mund të ndodhë dhe brenda Shqipërisë dhe shumë më pak e dinë se mund të ndodhë në komunitetin apo zonën e tyre. Te të rinjtë e anketuar në Dibër, më shumë femra sesa meshkujt e dinë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore dhe se kjo njohuri është më e gjerë te më të rinjtë dhe ata që jetojnë në zona rurale.

Të rinjtë në Dibër kanë më pak njohuri sesa popullsia e gjerë rreth formave të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit, veçanërisht për sa i përket kriminalitetit të detyruar të të rriturve. Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar në Dibër kanë pak njohuri rreth grupeve të tjera përveç vajzave (nën 18 vjeç) dhe minoriteteve kombëtare që mund të trafikohen, ndonëse femrat, 15-17 vjeçarët dhe personat që jetojnë në zona urbane dinë më shumë sesa të rinjtë e tjerë të anketuar, për sa i përket riskut për t'u trafikuar.

Të rinjtë në Dibër kanë njohuri rreth metodave të rekrutimit për trafikim të qenieve njerëzore, dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore. Megjithatë, pak e dinin se trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë edhe familjarët. Femrat, 25-29 vjeçarët dhe të rinjtë në zonat rurale kanë më shumë njohuri rreth metodave të rekrutimit të qenieve njerëzore.

Krahasuar me anketën e përgjithshme të popullatës në të katër qarqet e tjera, të rinjtë në Dibër kanë pak njohuri për mjetet e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, por ata që jetojnë në zona urbane kanë më shumë njohuri rreth këtyre mënyrave se sa ata që jetojnë në zona rurale.

Të rinjtë në Dibër kanë pak njohuri rreth shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Katër në dhjetë të rinj nuk janë në dijeni të llojit të mbështetjes në Shqipëri. Njohuritë për shërbimet mbështetëse ekzistuese janë më të mëdha te femrat e reja dhe te të rinjtë e moshës 18-24 vjeç.

Shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore mes të rinjve të anketuar në Dibër është më e lartë se sa në popullatën totale të anketuar në katër qarqe, me nivele më të larta shqetësimi te femrat, 18-29 vjeçarët dhe të rinjtë në zonat urbane.

Qëndrimet e të rinjve në Dibër kundrejt viktimave janë pozitive, me 89% që raportojnë se viktimave duhet t'u sigurohet mbështetje. Femrat, 15-17 vjeçarët dhe të rinjtë në zonat rurale kanë nivele më të larta empatie kundrejt viktimave dhe ndihen se duhet t'i ofrohet më shumë mbështetje.

Për sa i përket praktikës, të rinjtë në Dibër janë më shumë të interesuar të dinë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje. Interesi i të rinjve për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore është më i lartë te femrat dhe te grupmosha 15-17 vjeç.

Të rinjtë në Dibër janë gjithashtu më të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi. Femrat, të rinjtë e moshës 15-17 vjeç dhe të rinjtë që jetojnë në zonat urbane janë më të interesuar të përfshihen se të rinjtë e tjerë në Dibër.

Thujse gjysma e të rinjve të anketuar në Dibër raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të kaluara. Të gjithë te ekspozuarit ndaj materialeve të tilla (98%) raportuan se njohuritë e tyre për trafikimin e qenieve njerëzore janë shtuar si rrjedhojë e ekspozimit. Për më tepër, thujse të gjithë (97%) të rinjtë e ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore në dy vitet e fundit deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër këtij fenomeni.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se subjektet e përfshira në luftën kundër trafikimit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore të të rinjtë meshkuj e të gjitha grupmoshave, si dhe te të rinjtë në zona urbane në Dibër. Duhet t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të njohurive të të rinjve lidhur me: praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në komunitetin vendas; format e ndryshme të shfrytëzimit që ndodhin në vend dhe jashtë tij; faktin se djemtë dhe personat në zona rurale janë në risk për t'u trafikuar; se pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te subjekte të tjera veç policisë; dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet e parandalimit mund të synojnë edhe përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Programet e ardhshme të edukimit mund të shfrytëzojnë metoda komunikimi që janë popullore te të rinjtë të anketuar, konkretisht televizionin, mediat sociale, diskutimet në shkollë dhe materialet e shtypura.

unicef 

for every child